

**DOKUMENTACIONI DHE STANDARTET TEKNIKE QË DUHET TË PARAQESIN
SUBJEKTET PËR LINJËN RRETHQYTETËSE:**

Shkodër – Shosh – Shkodër me dy drejtime lëvizje

a. Shkodër-Shosh-Shkodër.

b. Shkodër-Koplik-Theth-Breg Lumi, Shalë-Shosh-Shkodër (kalim tranzit nga Kopliku dhe Njësia Shosh me dyer të mbyllura).

Baza Ligjore:

Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” i ndryshuar,
Udhëzimi nr. 5627, datë 18. 11. 2016 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit” i ndryshuar

Për pranimin në veprimtarinë e subjektit të transportit të udhëtarëve në plotësimin e kriterëve të nenit 4, të këtij udhëzimi, paraqiten dokumentet sipas Neni 9, pika 1.1, 1.2, 1.3

Të gjitha aplikimet pas datës së përcaktuar në njoftim nuk merren në shqyrtim.

1. Kërkesa për aplikim, lidhja 6 (tërhiqet dhe plotësohet te Zyra me një ndalesë)
2. Vetëdeklarimi për reputacionin e mirë të përfaqësuesit ligjor të subjektit transportues dhe drejtuesit/drejtuesve të veprimtarisë, lidhjet 7/1 dhe 7/2. (Neni 9, Pika 1.1, Gërma a)
(tërhiqet dhe plotësohet te Zyra me një ndalesë)
3. Dokumenti nga një institucion bankar ose financiar, **që vërteton gjendje të qëndrueshme financiare**, i cili mund të jetë:
 - i) një dokument/garanci bankare;
 - ii) një dokument I lëshuar nga shoqëri sigurimi.Këto dokumente duhet të parashikojnë një vlerë në përputhje me shumat e përcaktuara në pikën 1.2, të nenit 4, (140 000 lekë për mjetin e pare dhe 70 000 lekë për çdo mjet tjetër në përdorim) (neni 9, pika 1.1, gërma b), si dhe duhet të vërtetojmë se banka/shoqëria e sigurimit janë garant për subjektin që kërkon të licencohet.
Gjithashtu, do të pranohen dokumente të lëshuara nga çdo bankë, institucion financiar ose institucione të ngarkuara për këtë qëllim në çdo shtet anëtar të BE-së, ku individit ose subjekti i transportit rrugor apo filiali i tij është regjistruar.
4. Çertifikata e kompetencës profesionale për drejtuesin e veprimtarisë, i cili mund të jetë ortaku i vetëm ose një prej ortakëve, apo administratori i subjektit ose një person i punësuar me kontratë për një periudhë të paktën 5 vjeçare; (Neni 9, Pika 1.1, Gërma c)
5. Regjistrimi në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), ku objekti i veprimtarisë duhet të jetë “Për transport udhëtarësh brenda vendit”. (Neni 9, Pika 1.1, Gërma d)
Subjekti i transportit të ketë selinë në Shkodër.
6. Vërtetim nga administrata tatimore dhe nga bashkia përkatëse për shlyerjen e detyrimeve tatimore (dokumenti do të gjenerohet nëpërmjet ndërveprimit institucion me institucion nga sistemi i qarkullimit të dokumenteve me nënshkrim elektronik SQDNE); (Neni 9, Pika 1.1, Gërma f)
7. Vërtetim i gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) për administratorin dhe drejtuesin teknik të shoqërisë; (dokumenti do të gjenerohet nëpërmjet ndërveprimit institucion me institucion nga sistemi i qarkullimit të dokumenteve me nënshkrim elektronik SQDNE); (Neni 9, Pika 1.1, Gërma h)
8. Dokument i lëshuar nga gjykata, i cili të vërtetojë se administratori dhe drejtuesi teknik i shoqërisë nuk janë në proces penal. (Neni 9, Pika 1.1, Gërma i)

9. Leja e qarkullimit për çdo mjet (Neni 9, Pika 1.2, Gërma a)
10. Certifikata e kontrollit teknik të mjeteve (Neni 9, Pika 1.2, Gërma b)
11. Aktivlerësimi në plotësimin e kushteve të komoditetit të mjeteve në transportin e udhëtarëve brenda vendit, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), (Neni 9, Pika 1.2, Gërma c)
12. Çertifikata e kalibrimit të tahogرافit (Neni 9, Pika 1.2, Gërma d)
13. Regjistrimi I mjeteve në QKB. (Neni 9, Pika 1.2, Gërma e)
14. Leja e drejtimit për drejtuesin e mjetit, me kategoritë përkatëse për mjetin që drejton; (Neni 9, Pika 1.3, Gërma a)
15. Çertifikata e aftësisë profesionale (CAP) për drejtuesit e mjeteve (Neni 9, Pika 1.3, Gërma b)
16. Në rastin e shërbimeve të rregullta sipas pikës 1, të nenit 4, të ketë agjenci për shërbimin e udhëtarëve brenda vendit, ose kontratë me një agjenci transporti. (Për subjektet juridike) (Neni 9, Pika 1.4)
17. Policë sigurimi (Neni 9, Pika 1.5)
 - Sigurimin e udhëtarëve nga aksidentet në transportin public (Neni 9, Pika 1.5, gërma a)
 - Sigurimin e përgjegjësisë së pronarit ose të përdoruesit të mjetit motorik, për dëmet shkaktuar palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti (Neni 9, Pika 1.5, gërma b)
18. Listë me targat e mjeteve që duhet të përdorë (në formë përshkrimi dhe katalogu fotografik me ambjentet e brendshme dhe te jashtme të mjeteve)
19. Përbën avantazh referenca dhe çdo dokument tjetër që verteton eksperiencën në transportin e udhëtarëve.

Dokumentat e mësipërme duhet të jenë të njehsuara me origjinalin

STANDARTET TEKNIKE TË LINJËS

Shkodër – Shosh – Shkodër me dy drejtime lëvizje

a. Shkodër-Shosh-Shkodër.

b. Shkodër-Koplik-Theth-Breg Lumi, Shalë-Shosh-Shkodër (kalim tranzit nga Kopliku dhe Njësia Shosh me dyer të mbyllura).

Inventari i mjeteve (numri i mjeteve që duhet të disponojë operatori minimalisht për shërbim), sejcila linjë ka 4 orare dhe do të ketë 5 mjete, të cilët duhet të plotësojnë standartet dhe dokumentacionin e përcaktuar në legjislacionin në fuqi.

Linja në tërësi duhet të plotësojnë standartet:

1. Mjetet të jenë të rregullta nga pamja e jashtme dhe e brendshme, të jenë me kondicionim.
2. Mjetet që do të operojnë në linjë të jenë autobusë.
3. Viti i prodhimit të mjeteve të jetë 2011 e lart.